

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data : 07.08.2015]

Për: Shoqerine “Shqiponja -M” shpk me NIPT J78311934T.

Procedura e prokurimit: **“Procedurë e hapur”** me objekt : **“Rikonstruksioni i shkollës 9 vjecare Dërsnik, Komuna Voskop”.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Rikonstruksioni i shkollës 9 vjecare Dërsnik, Komuna Voskop”.**

Kohëzgjatja: **6 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.**

Fondi limit: **10.144.000 (dhjetë milion e njëqind e dyzet e katër mijë)** lekë pa tvsh.

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **Date 28.05.2015.**

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Nuk ka patur.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh

SHOQERIA

OFERTA

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh: **Nr**

1	Infini shpk	6,280,500
2	Nika shpk	6,469,898
3	Shqiponja M shpk	6,817,073
4	Shpresa shpk	7,077,579
5	Derveni 1 shpk	7,354,292
6	Avduli shpk	7,390,673
7	Shendelli shpk & Filipi shpk	7,393,705
8	Aldok shpk & Pelvis shpk	7,895,825
9	Beladi shpk	8,356,110

10	Be-Is shpk	8,796,976
11	Alb-Korca 2002 shpk	9,274,404
12	Caushi M shpk	Nuk ka paraqitur oferte

Jane skualifikuar ofertuesit e meposhtem me arsyet perkatese:

1. “Infinit” shpk per arsye se:

- a. nuk plotëson kriterin e vendosur në Dokumentat e Tenderit shtojca 10 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.1, gërma “e”, ku është kërkuar: “Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.” pasi vërtetimi i paraqitur nuk është në emer të shoqërisë.
- b. Nuk plotëson asnjë prej kushteve të vendosura piken 2.4 dhe 2.4.1 Kapaciteti Teknik në DST ku shprehet se Operatori Ekonomik duhet të ketë realizuar punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 5.000.000 (pese milion) leke pa tvsh dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

Ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku, gjatë tri viteve të fundit, është jo më pak se 20.000.000 (njetzet milion) leke pa tvsh.

Plotësimi i njërit prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Per te vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë formularët e vlerësimit sipas shtojcës perkatëse të DST të shoqëruar me kontratën/kontratat e nënshkruara nga palet, situacionet perfundimtare, aktet e kolaudimit dhe faturat tatimore perkatëse Operatori ekonomik nuk ka paraqitur faturat e TVSH-se per punimet e sjella.

2. “Nika” shpk per arsyen se:

- a. Nuk plotëson piken 2.4.6 në DST ku shprehet se makinerit e mesiperme nuk duhet të jene të angazhuara në kontrata të tjera. Per kete të paraqitet nje deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese se makinerite e mesiperme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë deklaruar në nje procedure tjetër tenderimi në të cilën nuk është shpallur ende fituesi.

3. “Avduli” shpk per arsye se:

- a. Vërtetimet e lëshuara e kanë kaluar afatin tre mujor të percaktuar në DST

4. “Caushi M” shpk per arsye se:

- a. Nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion

5. “Derveni 1” shpk per arsye se:

- a. Ka të hapur një ceshtje sekuestro aksionesh të shoqërisë nga ana e përbarimit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë shoqërinë “Shqiponja -M” shpk me NIPT J78311934T se oferta e paraqitur, me vlerë 6,817,073 (**gjashtë milion e tetëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e shtatëdhjetë e tre**) lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor:**

- **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
- **Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 10, Tirana, Albania**
- **Phone: 00355 4 2 235 597/8 (int.151)**
- **Fax: 00355 4 2 234 885**

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pese ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **21.07.2015**.

Ankesa:

Në datën 10.07.2015 ka paraqitur ankesë shoqëria "Avduli" shpk. Ankesës ju dha përgjigje në datën 15.07.2015.

Në datën 13.07.2015 ka paraqitur ankesë shoqëria "Shqiponja - M" shpk. Ankesës ju dha përgjigje në datën 15.07.2015. Në datën 16.07.2015 u bë rivleresimi në sistem.

Në datën 20.07.2015 ka paraqitur ankesë shoqëria "Shqiponja - M" shpk. Ankesës ju dha përgjigje në datën 21.07.2015. Në datën 21.07.2015 u bë rivleresimi në sistem.

Në datën 23.07.2015 ka paraqitur ankesë shoqëria "Derveni 1" shpk. Ankesa nuk u pranua se ishte jashtë afateve. Ankesës ju dha përgjigje në datën 27.07.2015

